



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:118715
Datë: 01.11.2023
Numri i dokumentit: 04859473

E.nr.10/12

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, sipas gjyqtarit Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen përmbartimore të kreditorit Nj.I. nga fsh ..., Komuna e Ferizajt, të cilin me autorizim e përfaqëson av Muhamed Beqiri nga Ferizaj, kundër debitorit NTPSH “A.”, Fabrika e vajit dhe yndyrave bimore, me seli në Ferizaj, për shkak të borxhit, më datë 01.11.2023, merr këtë.

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura përmbartimore sipas lëndës E.nr.10/12, për shkak të tentimit të përmbartimit të aktgjykimit C.nr.423/05, i datës 09.02.2011, më shumë se dy herë.

Procedura e pezulluar mund të vazhdoj nëse kreditori në afatin prej gjashtë (6) muajsh paraqet informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar, në të kundërtën procedura konsiderohet e përfunduar.

A r s y e t i m i

Kreditori Nj.I., më datë 11.01.2012, ka ushtruar propozim për përmbartim, sipas dokumentit përmbartimor, aktgjykimit C.nr.423/05, të datës 09.02.2011, kundër debitorit NTPSH “A.”, Fabrika e vajit dhe yndyrave bimore, me seli në Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe pagesën e shpenzimeve të përmbartimit.

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.10/12, të datës 09.10.2012, në bazë të propozimit të autorizuarit të kreditorit dhe aktgjykimit C.nr.423/05, të datës 09.02.2011, e ka lejuar përmbartimin kundër debitorit NTPSH “A.”, Fabrika e vajit dhe yndyrave bimore.

Gjykata në rastin konkret, me qëllim të ekzekutimit të aktgjykimit të cekur më lart, i ka ndërmarr një sërë veprimesh përmbartimore siç janë:

Pas lejitimit të përmbarimit, gjykata ka tentuar që t'ia dërgoj aktvendimin mbi lejitimin e përmbarimit debitorit mirëpo nga flet kthesa e kthyer nga posta është konstatuar se adresa e debitorit është e panjohur, gjegjësisht biznesi i debitorit është i mbyllur.

Po ashtu, gjykata edhe më datë 04.05.2015, ka tentuar që t'ia dërgoj ftesë debitorit me qëllim që të njëjtit t'ia dorëzoj propozimin për përmbarim mirëpo prap ka rezultuar se Fabrika e Vajit është e mbyllur.

Si përfundim, gjykata konstaton se meqenëse në këtë çështje përmbarimore është tentuar më tepër se dy her që të bëhet përmbarimi i titullit ekzekutiv, aktgjykimit C.nr.423/05, të datës 09.02.2011, erdhi në përfundimin se nuk ka pasur sukses që të bëhet ekzekutimi i aktgjykimit të cekur më lart edhe pse gjykata ka ndër marr një seri të veprimeve përmbarimore mirëpo pa arritur rezultatin e synuar që të bëhet ekzekutimi i aktgjykimit në fjalë. Në dispozitën e nenit 65, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të LPP-së thuhet:

“Përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj, përmbarimi pezullohet sipas detyrës zyrtare në këto rrethana: kur është tentuar nga organi përmbarues që të zbatohet përmbarimi i vendimit së paku dy (2) herë pa arritur asnjë rezultat të synuar nga këto veprime”.

Andaj, gjykata duke i marr parasysh faktet e cekura më lart, vendosi që procedurën e përmbarimit në këtë çështje përmbarimore ta pezulloj në bazë të nenit 65, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Procedurën e Përmbarimit dhe se procedura e përmbarimit në këtë çështje përmbarimore mund të vazhdoj nëse kreditori i ofron gjykatës informata të reja mbi mjetet apo pasurinë e debitorit.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.10/12, më datë 01.11.2023

GJYQTARI
Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.